



REPUBLIKA E SHQIPERISË

UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS

REKTORATI

DREJTORIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE DHE JURIDIKE

Nr. 1544 Prot.

Tiranë, më 14/05/2026

URDHËR

Nr. 29, datë 14.05.2026

PËR

SHPALLJEN E FILLIMIT TË PROCESIT ZGJEDHOR DHE PËRCAKTIMIN E DATËS SË ZHVILLIMIT TË ZGJEDHJEVE TË PJESSHME NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK TË TIRANËS

Mbështetur në ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 39, pika 1, si dhe Rregulloren “Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese 2024 – 2028, në Universitetin Politeknik të Tiranës” neni 4, pika 2, neni 5, pika 5,

URDHËROJ:

1. Shpalljen e fillimit të procesit zgjedhor dhe datën e zhvillimit të zgjedhjeve të pjesshme për anëtarë të Komisioneve të Përhershëm për Dhënien e Gradës Shkencore “Doktor” në 7 njësi kryesore, si dhe disa autoritete drejtuese në Universitetin Politeknik të Tiranës si më poshtë:
 - a) Drejtues i Departamentit të Inxhinierisë së Mjedisit në Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit;
 - b) Drejtues i Departamentit të Hidraulikës dhe Hidroteknikës në Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit;
 - c) Drejtues i Departamentit të Tekstilit dhe Modës në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike;
 - d) Drejtues i Departamentit të Mekanikës në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike.
2. Data e fillimit të procesit zgjedhor për anëtarë të Komisioneve të Përhershëm për Dhënien e Gradës Shkencore “Doktor”, si dhe disa autoritete drejtuese në Universitetin Politeknik të Tiranës, është data 25.05.2026.

3. Data e zhvillimit të zgjedhjeve për anëtarë të Komisioneve të Përhershëm për Dhënie e Gradës Shkencore “Doktor”, si dhe disa autoritete drejtuese në Universitetin Politeknik të Tiranës, është data 23.06.2026.
4. Ngarkohen Komisioni Institucional i Zgjedhjeve, Administratori i Institucionit si dhe Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Juridike për zbatimin e këtij urdhëri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

REKTORI

Prof. Dr. Akli Fundo

